



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:120451
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05871155

Ac.nr.877/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit, KEK sh.a. me seli në P....., Rr.”.....”, nr....., kundër debitorit F.N nga fshati S....., Komuna e V....., me bazë juridike përbarimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, PPP.nr.163/2019, i datës 29.12.2023, me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit KEK sh.a. me seli në P....., Rr. “.....”, nr....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, PPP.nr.163/2019, i datës 29.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.163/2019 i datës 29.12.2023, ka vendosur si në vijim: “*I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i datës 08.11.2019, i debitorit F.N nga fshati S....., Komuna e V.....,*

II. SHFUQIZOHET PJESËRISHT, Urdhri Përbarimor P.nr.473/2019, të datës 01.11.2019 i përbaruesit K.M nga Gjilani, për pjesën e borxhit në shumë prej 487.58 €.

III. Mbetet pjesërisht në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr.473/2019, i datës 01.11.2019, i përbaruesit K.M nga Gjilani, për pjesën e borxhit, vetëm sa i përket shumës prej 44.52 €.

IV. OBLIGOHET debitori F.N nga fshati S..... Komuna e V....., që kreditorit KEK me seli në P....., ne emër të borxhit për energjinë elektrike sipas Kontratës për pagesën e borxhit me këste,

t'ia paguaj shume prej 44.52 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes se këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditor duke filluar nga pranimi i këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm ”.

Kundër këtij aktvendimi kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim ose të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me datën 30.10.2019 kundër debitorit, për pagesën e faturave sipas Ekstraktit nga librat afariste me shenjën DGL, e datës 29.10.2019, në shumën totale prej 532.10 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Përmbaruesi privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim ka nxjerrë urdhrin P.nr.473/2019, i datës 01.11.2019, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, duke theksuar se dokumenti i besueshëm i lejuar nga përmbaruesi privat, është i pa bazuar në ligj për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të procedurës përmbarimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, për faktin se vendimi përmbarimor është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-ës, pasi që një borxh i tillë nëse ju referohemi nenit 360 të LMD-ës, nuk mund të kërkojë borxhin, për faktin se borxhi i tillë është parashkruar. Gjithashtu duhet të potencojë se deri në muajin Qershor 2019, i jam përmbarimor marrëveshjes dhe nuk kam pasur mungesa në pagimin e kësteve dhe vetëm një këste ka mbetur pa paguar, me të cilën ka ndodhur se unë jam anëtarë i vetëm në familje me të hyra financiare nga puna me taksit dhe se po në kohë e kam pasur bashkëshorten të sëmurë, dhe kishte kërkuar që të rikthehet marrëveshja në fuqi, respektivisht të paguhen këstet e mbetura, dhe kishte kërkuar që pas administrimit të provave të paraqitura nga debitori, të aprovohet prapësimi si i bazuar në tërësi dhe urdhri i lejuar nga përmbaruesi privat të anulohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, sa i përket pretendimit të debitorit se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat se është i pa bazuar dhe i pa argumentuar është i pa bazuar pasi që i njëjti urdhër është konform dispozitave ligjore të ligjit të LPP-ës, pasi që gjitha

dokumentet përmbartimore janë dokumente të besueshme konform nenit 29 të LPP-ës, pretendim tjetër i debitorit, se kreditori ka propozuar propozimin për përmbartim jashtë afatit kohorë pasi që një borxh i tillë është parashkruar konform nenit 360 i LMD-ës, është i pa bazuar pasi që kreditori dhe debitori me dt.01.09.2016, ka nënshkruar kontratën për pagesën e borxhit sipas Kontratës për pagesën e Borxhit dhe Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit, andaj pretendimet e debitorit janë të pa baza dhe të pa argumentuar me asnjë provë relevante të paraparë, andaj bazuar në argumentet e mësipërme konsiderojmë se kundërshtimi i debitorit është i pa argumentuar dhe i pa bazuar dhe propozojë që të refuzohet prapësimi dhe po që se është nevoja eventuale gjykata të caktoj seancë publike.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimi, me aktvendimin PPP.nr. 163/2019, i datës 23.05.2022, ka vendos që ta aprovoj pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit, duke e anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor, P.nr.743/2019, i datës 01.11.2019, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur kreditori për të cilën ka vendosur Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.4449/2022, të datës 05.07.2023, me të cilin e ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ndërsa e ka anuluar aktvendimin e lartcekur duke e kthyer çështjen në procedim të serishëm.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.163/2019, të datës 29.12.2023, me të cilin e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se debitori Florim Nazifi, ka nënshkruar marrëveshje me kreditorin, me datë 01.09.2016, me qëllim të përfitimit nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike, dhe sipas marrëveshjes është pajtuar që kreditorit t'ia paguaj borxhin prej 396.52 €, në gjithsej 18 këste, të përfshirë brenda periudhës kohore prej 06.09.2016 deri më 29.07.2019, të përcaktuar në deklaratën për akordimin e borxhit. Në pasqyrën e transaksionit të pagesës së borxhit, konstatohet se debitori ka paguar 16 këste, në vlerë prej nga 22 €, duke mbetur pa e paguar vetëm 2 këstet e fundit në vlerë prej 44.52 €. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nga marrëveshja e arritur mes debitorit dhe kreditorit për faljen e borxhit ka qenë që debitori të paguaj borxhin në vlerë prej 396.52 € dhe atë në 18 këste nga 22 €, me kusht që pjesa tjetër e borxhit të krijuar deri më datë 31 dhjetor 2008 në vlerë prej 487.58 € të falet. Debitori, sipas programit të pagesës së borxhit i ka paguar 16 këste, duke mbetur në vonesë vetëm dy këstet e fundit, në vlerë prej 44.52 €. Gjykata ka vlerësuar se prapësimi ka mbështetje në nenin 71 par. 1 pika 1.7, i cili përcakton se “kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj”, e në këtë rast gjykata, duke marrë për bazë nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike, i cili përcakton se: “Në rastet kur personi shkakton tri vonesa lidhur me pagesat sipas programit të pagesës së borxhit sipas marrëveshjes, pjesa e paguar e borxhit i fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”, është vërtetuar se debitori nuk e ka shkelur marrëveshjen ashtu siç parasheh dispozita më lartë, pasi që

nuk ka shkaktuar tri vonesa të njëpasnjëshme. Në këtë rast kontrata e lidhur konsiderohet se ende është në fuqi, pasi që nuk është përmbushur kushti në shkaktimin e tri vonesave të pagesës, kështu që debitorit, si detyrim i ka mbetur pagesa e vetëm dy këste dhe atë në shumë prej 44.52 €. Sa i përket pretendimit të debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës, gjykata e vlerësoj si të pabazuar, pasi që u konstatua se nuk ka parashkrim të kërkesës, për faktin se, debitori me rastin e pranimit të borxhit me datë 01.09.2016, e ka ndërprerë parashkrimin, dhe se pagesën e kështit të fundit e ka bërë me datën 04.04.2019 në shumën prej 22 €, e më pas edhe kreditori me rastin e dorëzimit të propozimit me datë 30.10.2019, kishte vepruar konform dispozitave ligjore të LMD-së, andaj nga të lartcekurat në bazë të nenit 29, 71 dhe 73 paragrafi 3 të LPP-së ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e pjesshëm të prapësimit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbartimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se ekstrakti në bazë të cilës është lejuar përmbartimi, është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Në kuptim të kësaj dispozite nënkuptojmë se organi përmbartues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbartues, ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së,

dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së, përcaktohet se: “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokumenti i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste* ”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si provë materiale përveç tjerash gjendet ekstrakti i verifikuar nga librat afariste nr. DGL-2000088, i datës 29.10.2019.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të prapësimit të palës debitore të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, P.nr. 473/2019 i datës 01.11.2019, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e aprovuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke shfuqizuar pjesërisht Urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr. 473/2019 i datës 01.11.2019, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, për arsye se në bazë të kontratës për pagesën e borxhit të lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, në nenin 3, parashihet se: “*Në rastet kur personi shkakton tri vonesa lidhur me pagesat sipas programit të pagesës së borxhit sipas marrëveshjes, pjesa e paguar e borxhit i fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet*”, mirëpo në këtë rast nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga deklaratat mbi dakordimin e borxhit, vërehet se debitori nuk i ka shkaktuar 3 vonesa të njëpasnjëshme, por vetëm dy të fundit, ndërsa pagesat e tjera janë kryer, andaj ky nen nuk mund të zbatohet vetëm për shkak të mos pagesës së dy kësteve në afatin e caktuar në bazë të kontratës, duke e vërtetuar se debitori nuk e ka shkelur marrëveshjen duke mos shkaktuar tri vonesa të njëpasnjëshme kështu që i ka mbetur vetëm pagesa e dy kësteve në vlerën prej 44.52 €, duke e lënë në fuqi për këtë pjesë urdhrin përmbartimor. Pra, në këtë rast Gjykata e Apelit e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë kur ka konstatuar se debitori nuk i ka shkaktuar tri vonesa të njëpasnjëshme dhe se kreditori nuk ka pasur të drejtë që të kërkojë nga përmbartuesi privat realizimin e totalit të borxhit në shumë prej 487.58 €, por vetëm shumën e borxhit 44.52 €, për dy këstet e fundit të mbetura.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: “ Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohen nga Gjykata”, pasi që është në diskrecionin e gjykatës që të vlerësojë se në cilat raste të caktojë seancë dhe se në këtë rast ka qenë e domosdoshme caktimi i seancës për shkak se nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës, nuk ka qenë e mjaftueshme që të vërtetohen të gjitha faktet e nevojshme për të vendosur dhe për të vlerësuar arsyet e theksuara në prapësim.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAP.nr.877/2024, me datë 25.06.2024

Gjyqtarja
Nora Bllaca-Dula, d.v